

## ARTIKUJ


### FAKTORËT PËRCAKTUES TË RITJES EKONOMIKE NË SHQIPËRI.

Vasilika Kota\*, kryespecialiste, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

#### HYRJE

Ky material paraqet një analizë të burimeve të rritjes ekonomike në Shqipëri pas periudhës së tranzicionit. Vlerësimi i përcaktuesve themelorë të rritjes ekonomike është i rëndësishëm për të kuptuar çfarë roli kanë luajtur në të kaluarën dhe si mund të jetë perspektiva e zhvillimit të tyre në të ardhmen. Krahasuar me vende të tjera të Evropës Qendrore apo Lindore, rritja ekonomike në Shqipëri pas viteve '90 është më e lartë se në shumicën e këtyre vendeve. Kështu, duke përjashtuar Poloninë dhe Turqinë të cilat kanë shfaqur një rritje ekonomike të qëndrueshme pas vitit '91, Shqipëria është e para midis vendeve të marra në konsideratë e cila në vitin 1999 (së bashku me Hungarinë) arriti të tejkalojë nivelin e PBB-së reale të vitit 1990. Për vendet e tjera, goditja e tranzicionit do të ishte mjaft e fortë dhe rimëkëmbja ekonomike mbi nivelin e vitit '90 filloi vetëm pas vitit 2003. Ndërkohë që Maqedonia, Bullgaria apo Letonia ende nuk kanë arritur nivelin real të PBB-së që kanë pasur në vitin '90.

Grafik 1. Indeksi i PBB-së reale (1990=100) për Shqipërinë (majtas) dhe për vende të Evropës Qendrore dhe Lindore<sup>1</sup> për vitin 2009 (djathtas).



Burimi: World Economic Outlook (Prill 2010).

1) Të dhënat për periudhën para vitit 1994 për një pjesë të vendeve, janë marrë nga materiali "Rapid Growth in Transition Economies: Growth-Accounting Approach", Garbis Iradian (2007).

Një vështrim më i detajuar i rritjes ekonomike në Shqipëri paraqitet në grafikun 2. Gjatë fillimit të tranzicionit 1990-1992, PBB-ja reale në Shqipëri ra me një përqindje kumulative prej 39 për qind. Politikat e zbatuara gjatë vitit 1993 me qëllim stabilizimin makroekonomik të vendit, ndihmuan në ripërtëritjen dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike. Ndërmjet viteve 1993 deri 1996, rritja mesatare vjetore arriti në 9.3 për qind. Kriza e skemave piramidale gjatë vitit 1997, shkaktoi një rënie ekonomike prej 11 për qind. Megjithatë, ekonomia u ripërtëri shpejt dhe norma e rritjes së PBB-së reale për vitin 1998

arriti 8.6 për qind. Kjo rritje ishte edhe më e lartë për vitet në vazhdim dhe u stabilizua gjatë viteve 2001-2002, me një normë mesatare 6.5 për qind. Gjatë krizës ekonomike të vitit 2002, ekonomia u rrit vetëm me 4.3 për qind. Ndërkohë duke filluar nga viti 2003 rritja mesatare vjetore ka qenë 6 për qind. Pas një niveli prej 7.85 për qind të rritjes vjetore në vitin 2008, kriza financiare botërore u reflektua në ngadalësimin e rritjes ekonomike duke shënuar vetëm 3.3 për qind në vitin 2009.


Për shkak të strukturës joeficiente të organizimit të ekonomisë që Shqipëria trashëgoi nga sistemi komunist, procesi i tranzicionit u shoqërua me ristrukturimin e aktiviteteve ekonomike. Duke filluar nga viti 1990, pesha e sektorit të industrisë është zvogëluar nga 39 për qind, në rreth 7.6 për qind në vitin 2009. Ndërkohë një zgjerim të dukshëm ka pësuar sektori i ndërtimit i cili u zgjerua nga niveli rreth 3 për qind i PBB-së në vitin 1990, në 14.5 për qind në vitin 2009. Ngushtimi i sektorit të industrisë lejoi përdorimin e faktorëve të prodhimit nga sektorët e tjerë. Një zgjerim të konsiderueshëm pësoi sektori i shërbimeve, pesha e të cilit në PBB u rrit nga 33 për qind në 63 për qind. Sektori i bujqësisë pësoi fillimisht një rritje nga 23 në 32 për qind deri në vitin 1997 dhe më pas, u ngushtua në nivelin 19 për qind të PBB-së në vitin 2009. Kriza financiare duket se u reflektua më shumë mbi sektorin e industrisë, i cili në vitin 2009 u ngushtua me 2.5 pikë përqindjeje në raport me PBB-së ndërkohë që sektori i shërbimeve vazhdoi të zgjerohej me 5.4 pikë përqindjeje ndaj PBB-së krahasuar me vitin 2008.

Pas pasqyrimin të zhvillimeve në rritjen ekonomike, është e rëndësishme të kuptojmë cilat kanë qenë burimet kryesore të rritjes që kanë përcaktuar zhvillimin ekonomik të vendit. Për të shpjeguar përcaktuesit kryesorë të rritjes ekonomike, literatura empirike sugjeron dy përjasje (Khan, 2004):

1. Së pari, modeli neoklasik i rritjes ekonomike sugjeron shpërbërjen e normës së rritjes ekonomike sipas kontributit të burimeve themelore të rritjes ekonomike të tillë si: kapitali njerëzor, stoku i kapitalit fizik dhe rritja e Produktivitetit Total të Faktorëve të Prodhimit (e njohur si TFP).
2. Së dyti, gjatë ndërtimit të analizave krahasuese të rritjes ekonomike midis vendeve të ndryshme, janë identifikuar burimet strukturore të rritjes ekonomike të tilla si: norma e investimeve, norma e regjistrimit në shkollë, integrimi në tregtinë ndërkombëtare, stabiliteti makroekonomik, infrastruktura dhe cilësia e institucioneve. Kuptohet se këta variabla strukturore kontribuojnë në zhvillimin e një apo disa burimeve themelore të rritjes ekonomike të cilat përdoren në përjasjen e parë.

Gjatë këtij materiali, do të analizohet rritja ekonomike në Shqipëri duke identifikuar burimet themelore të saj përmes përjasjes së parë.

Grafik 2. Norma e rritjes reale ekonomike në Shqipëri gjatë periudhës 1990-2009 (boshti djathtas) dhe përbërja sektoriale e PBB-së (boshti majtas).



Burimi: World Development Indicators (2003) për PBB-në dhe peshat e sektorëve gjatë periudhës 1990-1995, INSTAT për periudhën 1996-2009. Peshat e sektorëve për vitin 2009 janë vlerësim paraprak bazuar në vlerësimin e INSTAT-it për tremujorin e parë 2009 publikuar në korrik 2009.

## METODOLOGJIA DHE TË DHËNAT

Për të identifikuar burimet e rritjes ekonomike, përfaqja e parë bazohet në ndërtimin e modelit Solow ose i njohur ndryshe si modeli Neoklasik i rritjes ekonomike. Ky model identifikon si përcaktues të rritjes ekonomike, produktivitetin e punës, produktivitetin e kapitalit si dhe normën e TFP. Norma e TFP përcaktohet nga mbetja e modelit dhe është një vlerësim për ndryshimin në Produktivitetin Total të Faktorëve dhe ndër të tjera reflekton edhe supozimet metodologjike dhe gabimet në matje të faktorëve të prodhimit. Kjo mbetje përcaktohet si rritja në nivelin e prodhimit që ndodh kur faktorët e rritjes ekonomike (punë dhe kapital) nuk ndryshojnë. Pra, interpretimi i saj varet nga përcaktimi që i jepet faktorëve punë dhe kapital. Duke qenë se te modeli bazë Solow nuk identifikohen variabla të tillë si niveli i shkollimit apo i eksperiencës në punë (të cilët ndikojnë faktorin punë) si dhe kapaciteti i përdorimit të kapitalit (që ndikon faktorin kapital), atëherë në mënyrë automatike këto përfshihen në vlerësimin e TFP. Modeli Solow prezantohet në formën e një funksioni agregat prodhimi Cobb Douglass si më poshtë:

$$Y = A \cdot L^{\alpha} \cdot K^{1-\alpha} \quad (1)$$

Ku A është produktiviteti total i faktorëve të Prodhimit (TFP), L është faktori punë i prodhimit, K është stoku i kapitalit dhe  $\alpha$  është elasticiteti i punës (gjithashtu edhe pjesa e të ardhurave nga puna në të dhënat totale). Linearizimi i funksionit të prodhimit është si më poshtë:

$$\frac{dY}{Y} = \underbrace{\alpha \frac{dL}{L}}_{\text{rritja-e-PBB kontributi-nga-punësimi}} + \underbrace{(1-\alpha) \frac{dK}{K}}_{\text{kontributi-nga-kapitali-fizik}} + \underbrace{\frac{dA}{A}}_{\text{kontributi-nga-TFP}} \quad (2)$$

Ku produktiviteti total i faktorëve të prodhimit (TFP) përfitohet si një mbetje e ekuacionit:

$$A = \log(Y) - [\alpha \log(L) + (1 - \alpha) \log(K)] \quad (3)$$

Për shkak se mungojnë të dhënat mbi pjesën e të ardhurave të faktorit punë ( $\alpha$ ) është përdorur supozimi i njohur gjerësisht në literaturë sipas të cilit 70 përqind e totalit të të ardhurave janë nga faktori i prodhimit punë dhe vetëm 30 përqind e të ardhurave vijnë nga stoku i kapitalit.

Problemi i dytë është vlerësimi i stokut të kapitalit pasi në Shqipëri mungojnë të dhënat mbi këtë seri. Për këtë qëllim, është përdorur një vlerësim i stokut të kapitalit për vitin 1996<sup>2</sup> dhe më pas janë shtuar të dhënat mbi investimet të cilat janë marrë nga INSTAT. Norma vjetore e zhvlerësimit të kapitalit është supozuar 8 përqind dhe vlerësimi i stokut të kapitalit është si më poshtë:

$$K(t+1) = K_t + I_t - \delta \cdot K_t \quad (4)$$

Ku  $K_t$  është stoku i kapitalit në kohën  $t$ ,  $I_t$  është norma e investimeve dhe  $\delta$  është norma e zhvlerësimit të kapitalit. Një informacion më i plotë mbi ndërtimin e këtyre të dhënave prezantohet në materialin Kota (2009).


Analiza e burimeve të rritjes ekonomike është ndërtuar me të dhëna vjetore për periudhën 1996-2009. Të dhënat mbi punësimin total për këtë periudhë janë marrë nga INSTAT. Stoku i kapitalit është vlerësuar sipas metodologjisë të prezantuar më lart për periudhën 1996-2007 pasi këtu përfundojnë të dhënat mbi investimet nga INSTAT. Ndërkohë që ekstrapolimi i investimeve për periudhën 2008-2009 është bërë duke përdorur kalibrimin. Të dhënat e Bankës së Shqipërisë mbi përdorimin e kredive nga ana e klientëve të bankave, tregojnë se rreth 1/3 e totalit të kredive shkon për investime. Duke përdorur normat e rritjes së kredisë për 2008-2009 është ekstrapoluar ecuria e investimeve private gjatë kësaj periudhe, të cilat më pas janë përdorur për të vlerësuar stokun e kapitalit. Duke qenë se investimet publike zënë rreth 15 për qind të investimeve totale, ecuria e investimeve private është thelbësore për të përcaktuar zhvillimet në stokun e kapitalit. Gjithsesi, ky mbetet një vlerësim i ecurisë reale të investimeve ndaj periudha 2008-2009 mund të përdoret thjesht për të krijuar një ide mbi kontributin e faktorëve të prodhimit dhe analiza mbi të mund të konsiderohet si orientuese dhe jo përfundimtare.

### BURIMET E RITJES EKONOMIKE - REZULTATET

Kontributi i faktorëve të prodhimit (punë dhe kapital) në rritjen ekonomike duke e matur nëpërmjet normës së rritjes së këtyre faktorëve të peshuar me pjesën e tyre në totalin e të ardhurave, prezantohet në grafikun 3.

Rezultatet sugjerojnë se deri në vitin 2000, kontributi kryesor në rritjen ekonomike është dhënë nga rritja e TFP-së, ndërkohë që zgjerimi i kreditimit të ekonomisë që filloi pas vitit 2000 është reflektuar në rritjen e kontributit të stokut të kapitalit në periudhën e dytë të marrë në studim. Duke u ndalur më gjerësisht, gjatë periudhës së rimëkëmbjes ekonomike pas krizës së vitit '97 (1998-2000), kur norma e rritjes ekonomike ishte mesatarisht 9.7 për qind, TFP-ja u rrit mesatarisht me 9.3 për qind, ndërkohë që stoku i kapitalit gjatë së njëjtës periudhë është rritur me 1.4 për qind. Gjatë viteve 2001-2007, rritja mesatare vjetore e ekonomisë është 5.8 për qind dhe kontributi kryesor në rritjen ekonomike vjen nga stoku i kapitalit mesatarisht me 3 për qind, ndërkohë që rritja e TFP-së është faktori i dytë përcaktues me një rritje mesatare prej 2.45 për qind. Për sa i përket faktorit të prodhimit punë, i matur nëpërmjet punësimit zyrtar, kontributi i tij ka qenë mjaft i ulët dhe me raste edhe negativ (para vitit 2000). Një ndër arsyt kryesore mund të jetë edhe problemi i të dhënave statistikore në lidhje me punësimin, të cilat nuk përfshijnë vlerësime për tregun joformal të punës i cili është mjaft i përhapur në Shqipëri. Gjithsesi, duhet të mbajmë parasysh se faktori punë në rastin tonë përfshin kontributin e punësimit në rritjen ekonomike, ndërkohë që përmirësimet e mundshme në cilësinë e punës reflektohen në rritjen e TFP.

Grafik 3. Rritja ekonomike dhe faktorët e prodhimit.



Burimi: Llogaritje të autorit.

Rezultate të ngjashme për rastin e Shqipërisë janë provuar edhe nga autorë të tjerë. Këtu mund të përmendim Khan (2004) i cili evidenton rolin përcaktues të TFP-së në rritjen ekonomike në Shqipëri. Si në rastin e rezultateve të paraqitura më lart, Khan (2004) gjithashtu gjen se normat e rritjes së TFP-së gjatë viteve të fundit kanë ardhur drejt rënies, duke u shoqëruar nga një rritje modeste e kontributit të punës dhe kapitalit. Sipas Khan (2004) tre mund të jenë burimet e rritjes së TFP-së në vendet në tranzicion:


- Rritja e menjëhershme e TFP-së gjatë tranzicionit për shkak të rishpërndarjes së faktorëve të prodhimit dhe transformimit të ekonomisë.
- Përmirësimi i TFP-së për shkak të përmirësimit të shpërndarjes së burimeve si rezultat i reformave strukturore.
- Përmirësimi i TFP-së si rezultat i gjetjeve të reja dhe mësimimit nga ana e sipërmarrësve.

Gjetjet sugjerojnë se burimi kryesor i rritjes së TFP-së ka qenë burimi i parë. Në fillimet e tranzicionit, për shkak të rishpërndarjes së burimeve të ekonomisë është e pritshme që TFP-ja të luajë një rol të rëndësishëm. Por kontributi i këtij faktori zvogëlohet me kalimin e kohës dhe stoku i kapitalit dhe punësimi fillojnë të ndikojnë ndjeshëm mbi rritjen ekonomike. Një rezultat i ngjashëm duket edhe në rastin e Shqipërisë, ku ngadalësimi i rritjes së TFP-së u pasua me një rritje të kontributit të kapitalit të akumuluar. Gjithsesi, roli i rëndësishëm i kombinimit të faktorëve të prodhimit përmes TFP-së është rikthyer gjatë krizës financiare botërore 2008-2009. Për shkak të reduktimit të ndjeshëm të normës së rritjes së kredisë, e cila nga 53 për qind rritje vjetore në 2007, u zvogëlua në 44 për qind në 2008 ndërkohë që gjatë vitit 2009 kjo normë u përgjysmua në 25 për qind, kontributi i stokut të kapitalit u ngadalësua.

Së fundi, rezultatet e analizës sugjerojnë se punësimi nuk ka kontribuar në rritjen ekonomike (këtu duhet të kujtojmë edhe një herë se përmirësimi i cilësisë së punës reflektohet në termin TFP). Gjithsesi, një proces i rëndësishëm i mbështetjes së rritjes ekonomike nëpërmjet burimeve njerëzore, është përdorimi i tyre me produktivitet. Sipas Kota (2007) pavarësisht se faktori punë nuk ka dhënë kontribut në rritjen ekonomike totale, produktiviteti i punës në Shqipëri është përmirësuar. Ky proces është mjaft i rëndësishëm për konvergimin e ekonomisë shqiptare drejt ekonomive më të zhvilluara. Ekonomitë e vendeve me shkallë të ndryshme zhvillimi shfaqin mjaft heterogjenitet dhe dinamikë në nivelin sektorial apo të firmave. Këto vende karakterizohen nga nivele të ndryshme produktiviteti dhe rritja e tij është burimi kryesor i rritjes ekonomike afatgjatë.

Nëse punësimi është i përqendruar në sektorë me nivel të ndryshëm produktiviteti që shoqërohen me mungesë efieciencie, atëherë stimulimi i rritjes ekonomike kërkon fillimin e procesit të ristrukturimit të ekonomisë. Punësimi do të zhvendoset nga sektorët më pak produktivë te sektorët më produktivë. Procesi do të përfundojë me rishpërndarjen e eficientë të punësimimit që stimulon rritjen e produktivitetit sektorial, agregat dhe ekonomik të vendit.

Siç u diskutua në grafikun 2, procesi i tranzicionit në Shqipëri u shoqërua me ristrukturimin e aktiviteteve ekonomike. Një ristrukturim i tillë duhet të pasohej edhe me riorganizim të tregut të punës. Grafiku 4 paraqet ecurinë e punësimit sipas sektorëve dhe të produktivitetit të punës sipas sektorëve. Produktiviteti i punës është përcaktuar si raporti midis vlerës së shtuar dhe punësimit në çdo sektor.



Ndërkohë që sektori i bujqësisë ka produktivitetin më të ulët, rezulton se ai ka nivelin e punësimit më të lartë. Problem në këtë rast përbëjnë të dhënat mbi nivelin e punësimit pasi INSTAT përdor supozimin se çdo person që zotëron tokë është i punësuar. Gjithsesi një sjellje e ngjashme shfaqet dhe në sektorët e tjerë. Kështu, sektori i shërbimit me nivelin më të lartë të produktivitetit të punës ka rreth 60 për qind të totalit të të punësuarve. Ndërkohë që sektori i ndërtimit, i dyti për nga niveli i lartë i produktivitetit ka vetëm 6 për qind të punësimit total. Një vështrim i thjeshtë mbi këto të dhëna sugjeron se shpërndarja e punësimit sipas sektorëve nuk është efiçente, të paktën duke përdorur të dhënat zyrtare mbi punësimin të cilat gjithsesi nuk përfshijnë tregun joformal. Por në nivel agregat (për të gjithë ekonominë), produktiviteti i punës është rritur mesatarisht me 6.4 për qind për të gjithë periudhën 1996-2008. Për këtë arsye është me interes identifikimi i faktorëve kryesorë pas këtij zhvillimi.

#### PRODUKTIVITETI I PUNËS - BURIMET E RITJES SË TIJ

Për të identifikuar burimet kryesore të zhvillimeve në produktivitetin e punës në Shqipëri është përdorur metodologjia e zbatuar nga Kota (2007) sipas së cilës faktorët përcaktues të përmirësimit të produktivitetit të punës janë: rritja brenda sektorit e produktivitetit të punës, rishpërndarja e punësimit midis sektorëve dhe konvergimi i sektorëve drejt një niveli mesatar produktiviteti, i cili mund të konsiderohet si niveli ekuilibër. Kjo metodologji e ka fillesën në

punën e Maliranta dhe Ilmakunnas (2005) dhe është përdorur gjerësisht për të analizuar produktivitetin e punës (për shembull, Fagerberg, 2000; Timmer dhe Szirmai, 2000; Jalava dhe të tjerë, 2002; Van Ark dhe Timmer, 2003). Shpërbërja e normës së rritjes së produktivitetit të punës është si më poshtë:

$$\frac{\Delta LP_t}{LP_t} = \underbrace{\sum_i \overline{LSH}_i \cdot \frac{\Delta LP_i}{LP_i}}_{\text{Efekti-brenda-sektorial}} + \underbrace{\sum_i \overline{LSH}_i \cdot \left( \frac{\overline{LP}_i}{LP_t} - 1 \right) \cdot \frac{\Delta LP_i}{LP_i}}_{\text{Termi-i-konvergencës}} + \underbrace{\sum_i \frac{\overline{LP}_i}{LP_t} \cdot \Delta LSH_i}_{\text{Efekti-i-rishpërndarjes-së-punësimit}} \quad (5)$$

Ku LP është produktiviteti i punës në ekonomi në kohën t,  $\overline{LSH}_i$  është pesha mesatare e punësimit për sektorin i për periudhat 1 dhe 0,  $\Delta LP_i$  është diferenca e produktivitetit të punës për sektorin i për të njëjtat periudha,  $\overline{LP}_i$  është niveli mesatar i produktivitetit përkatës dhe  $\Delta LSH_i$  është diferenca në peshën e punësimit për sektorin i, për periudhat 1 dhe 0.

Të dhënat e përdorura janë produktiviteti i punës, i llogaritur si raporti midis vlerës së shtuar dhe punësimit për çdo sektor si dhe niveli i punësimit. Të dhënat janë vjetore për periudhën 1996-2008 dhe janë marrë nga INSTAT dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për punësimin sipas sektorëve në vitin 2008.

Për sa i përket efekteve të cilat përcaktojnë edhe burimet kryesore të zhvillimeve në produktivitetin e punës, ato përcaktohen si më poshtë:

- Efekti brendasektorial - Rritja e produktivitetit të punës për shkak të përmirësimit të eficiencës së sektorit.
- Termi i konvergencës – Rritja e produktivitetit të punës për shkak të konvergimit të sektorëve drejt nivelit ekuilibër (mesatarja e ekonomisë).
- Efekti i rishpërndarjes së punësimit - rritja e produktivitetit të punës për shkak të lëvizjes së punësimit nga sektorët joproductivë drejt atyre produktivë.

Bazuar në këto përkufizime, në rastin e sektorit të bujqësisë i cili ka nivelin më të ulët të produktivitetit të punës, do të pritej zhvillimi i të dy proceseve të mundshme:

- Niveli i ulët i produktivitetit bujqësor do të shoqërohet nga rishpërndarja e faktorit punë nga ky sektor drejt sektorëve me produktivitet më të lartë.
- Në rast se zhvillohet procesi i konvergimit ndërsektorial, atëherë sektori i bujqësisë duhet të reflektojë norma më të larta rritjeje të produktivitetit të brendshëm, në mënyrë që të arrijë mesataren agregate të produktivitetit për të gjithë sektorët.

Ndërkohë që për sektorët e tjerë, zhvillimi i këtyre fenomeneve do të varej nga ecuria e produktivitetit të punës në nivel sektorial dhe gjithashtu edhe nga zhvillimet e përgjithshme në ekonomi. Aplikimi i metodologjisë së prezantuar në këtë pjesë do të paraqitet në vijim.

REZULTATET E ZBËRTHIMIT TË RRIJTJES SË PRODUKTIVITETIT AGREGAT  
SIPAS EFEKTEVE PËRCAKTUESE TË TIJ


Grafiku 5 paraqet rezultatet e zbërthimit të rritjes së produktivitetit agregat të punës sipas efektit brendasektorial, termit të konvergjencës dhe efektit të rishpërndarjes së punësimit midis sektorëve.

Rezultatet sugjerojnë se termi kryesor i cili ka kontribuar në rritjen e produktivitetit të punës në Shqipëri është efekti brendasektorial që nënkupton rritje të produktivitetit për shkak të përmirësimit të eficiencës së sektorit. Në vitin 2001 ka një thyerje strukturore të të dhënave për shkak të ndryshimit të metodologjisë së matjes së punësimit nga INSTAT, ndaj ky vit nuk merret në konsideratë në analizë.

Rezultatet e analizës sugjerojnë se efekti i rishpërndarjes së punësimit nuk ka dhënë një kontribut të lartë në zhvillimet e produktivitetit. Punësimi zyrtar sipas sektorëve vit pas viti është i qëndrueshëm dhe kjo mund të jetë ndikuar nga mospërfshirja e tregut informal të punësimit. Duke përjashtuar bujqësinë për shkak të peshës së lartë që ka në totalin e punësimit, kontribuesi më i madh në efektin e rishpërndarjes së punësimit është sektori i shërbimeve. Niveli i lartë i produktivitetit në këtë sektor është shoqëruar me rritjen e nivelit të punësimit në të. Sektori i ndërtimit tregon gjithashtu një efekt pozitiv të rishpërndarjes së punësimit, sidomos para vitit 2001. Për shkak të rritjes së produktivitetit në këtë sektor, pesha e tij në punësim është rritur konsiderueshëm duke kontribuar pozitivisht në rritjen totale të produktivitetit.

Një ndër arsyt pse sektori i bujqësisë nuk karakterizohet nga norma të larta të lëvizjes së punësimit si mund të pritej, mund të jetë se forca punëtore që duhet të lëvizë, nuk shfaq aftësitë e duhura të cilat kërkohen nga sektorët më produktivë. Ky problem, thekson nevojën për rritjen e aftësive të forcës punëtore, me qëllim stimulimin e produktivitetit dhe rrjedhimisht, edhe të rritjes ekonomike në Shqipëri. Gjithsesi, duke qenë se sektori i bujqësisë është i vetmi sektor me nivelin e produktivitetit më të ulët se niveli mesatar agregat, ai ka konverguar vazhdimisht drejt mesatares së ekonomisë duke pasur norma pozitive të rritjes së produktivitetit. Por nga ana tjetër, sektorët më produktivë (ndërtimi dhe shërbimet) vazhdojnë të kenë norma të larta rritjeje vjetore të eficiencës së tyre dhe pavarësisht konvergimit të sektorit të bujqësisë, ekonomia nuk ka arritur ende një nivel të qëndrueshëm produktiviteti.

Grafik 5. Produktiviteti i punës në Shqipëri.



Burimi: Llogaritje të autorit.

Procesi i rritjes së vazhdueshme të sektorëve produktivë i shoqëruar me procesin e konvergimit të sektorit joeficient, pritet të stimulojë një rritje të mëtejshme të produktivitetit në Shqipëri. Kjo do të jetë dhe një bazë e mirë për rritjen e kontributit të faktorit punë në rritjen ekonomike në të ardhmen.

#### PËRFUNDIME

Burimi kryesor i rritjes ekonomike në Shqipëri ka qenë përmirësimi i TFP, ndërkohë që pas vitit 2000 një rol të rëndësishëm ka luajtur stoku i kapitalit. Rrjedhimisht, për shkak se pas tranzicionit rritja e TFP për shkak të riorganizimit të ekonomisë do të vijë gradualisht drejt zvogëlimit dhe zhvillimet në normën e rritjes së investimeve kanë treguar luhatje nga viti në vit, është e rëndësishme që Shqipëria të krijojë burime alternative të rritjes ekonomike. Në këtë kuadër, akumulimi i kapitalit përmes stimulimit të investimeve merr një rëndësi të veçantë. Gjithashtu, është e rëndësishme të krijohen edhe përmirësime të tjera të TFP nga burime alternative, siç mund të jetë përfitimi nga njohuritë teknologjike, rritja e eficiencës sipërmarrëse gjatë kohës etj. Së fundi, për shkak të konvertimit të sektorëve drejt rritjes së produktivitetit të punës në Shqipëri, është e rëndësishme të përmirësohet cilësia e këtij faktori prodhimi.

## SHËNIME

\* Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

<sup>1</sup> Akronimi i emërtimeve të vendeve është si më poshtë:

ALB-Shqipëri, BIH- Bosnje dhe Hercegovinë, BGR-Bullgari, HRV-Kroaci, EST-Estoni, HUN-Hungari, LVA-Letoni, LTU-Lituani, MAC-Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, POL-Poloni, ROM-Rumani, TUR-Turqi.

<sup>2</sup> Të dhënat janë një vlerësim dhe janë siguruar në bazë të kërkesës së autorit drejtuar Geoffrey B.Oestreicher, FMN

## REFERENCA

Fagerberg, Jan, (2000), Technological Progress, Structural Change and Productivity Growth: A Comparative Study. *Structural Change and Economic Dynamics* 11: 393-411.

Iradian Garbis, (2007), "Rapid Growth in Transition Economies: Growth-Accounting Approach", IMF working paper, No. 164

Jalava, Jukka, S. Heikkinen, and R. Hjerpe, (2002), "Technology and Structural Change: Productivity in the Finnish Manufacturing Industries, 1925-2000". Paper presented at "XIII Economic History Congress," Buenos Aires, 28 June 2002.

Khan Faruk, (2004), "Albania: Growth during Transition and Growth Prospects", Working Paper, World Bank.

Kota, Vasilika, (2009), "Metoda alternative të matjes së produktit potencial në Shqipëri", *Material Diskutimi, Banka e Shqipërisë*, 3(30).

Kota, Vasilika (2007), "Produktiviteti i punës në Shqipëri: Procesi i konvergimit sektorial", *Buletini Ekonomik, Vëllimi 10, Nr. 4*, faqe 87-102, Dhjetor 2007.

Maliranta Mika, Ilmakunnas Pekka, (2005), "Decomposing productivity and wage effects of Intra-establishment labor restructuring", Nr. 993.

Timmer, Marcel P. and A. Szirmai, (2000), "Productivity Growth in Asian Manufacturing: The Structural Bonus Hypothesis Examined". *Structural Change and Economic Dynamics* 11: 371-392.

Van Ark, Bart and M. Timmer, (2003), "Asia's Productivity Performance and Potential: The Contribution of Sectors and Structural Change", Paper presented at the conference "Leading East Asia in the 21st Century," Tokyo, 30 May 2003.